

VENDIM
Nr. 50, datë 16.1.2013

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA BASHKIA ÇOROVODË TE MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS, TË SIPËRFAQES PREJ 3538 M², PJESË E PRONËS TRUALL ME NR. 8/45, TË ZONËS KADASTRALE 1420, ÇOROVODË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 902, DATË 21.12.2011 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË ÇOROVODË TË QARKUT TË BERATIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, 13 e 15 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga bashkia Çorovodë te Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, të sipërfaqes prej 3538 (tre mijë e pesëqind e tridhjetë e tetë) m², pjesë e pronës truall me nr. 8/45, të zonës kadastrale 1420, Çorovodë, për t’u përdorur për ndërtimin e godinës së centralit të HEC-it Vlushë.

2. Sipërfaqja 3538 (tremijë e pesëqind e tridhjetë e tetë) m², pjesë e pronës truall me nr. 8/45, të zonës kadastrale 1420, sipas genplanit përkatës, të hiqet nga lista e inventarit, që i bashkëlidhet vendimit nr. 902, datë 21.12.2011 të Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Brendshme, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Çorovodë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha